



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM

Nr. 32, datë 27.04.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.17, DATË 02.03.2018 "PËR
LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME LIBOHOVË"**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr.29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a Ujësjetllës Kanalizime Libohovë. për licencim për efekt të ndryshimit të zonës së shërbimit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Libohovë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 17, datë 02.03.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Libohovë;
- Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Libohovë ju la detyrë të aplikojë për zgjerim të zonës së shërbimit për Njësitë administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie menjëherë pas reflektimit të tyre në QKB;
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Libohovë ka aplikuar me anë të shkresës nr. 72 prot. datë 17.04.2018, për ndryshimin e licencës për efekt të zgjerimit të zonës së shërbimit;

- Aplikimi i shoqërisë sh.a Ujësjetllës Kanalizime Libohovë plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit mbi ndryshimin e zonës së shërbimit, konkretisht:
 - Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Libohovë ka rritur kapitalin e shoqërisë duke zmadhuar vlerën e aseteve të shtuara sipas VKM nr.63 datë 27.01 .2016;
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr.17, datë 02.03.2018 "Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Libohovë " ndryshohet si më poshtë:
"Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Libohovë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani